**LIGJ**
**Nr. 53/2026**

# PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 72/2012 "PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E INFRASTRUKTURËS KOMBËTARE TË INFORMACIONIT GJEOHAPËSINOR NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË", I NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 72/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e infrastrukturës kombëtare të informacionit gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Pas pikës 14 të nenit 3 shtohet pika 14/1 me këtë përmbajtje:
"14/1. "Ministri" është ministri përgjegjës për mbrojtjen.".

Neni 2

Në nenin 6 bëhen ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:
1. Në pikën 1 fjalët "në varësi të Kryeministrit" zëvendësohen me fjalët "në varësi të ministrit përgjegjës për mbrojtjen".
2. Në fund të pikës 3 shtohen fjalët "me propozim të ministrit".

Neni 3

Pika 2 e nenit 8 ndryshohet si më poshtë:
"2. Drejtori i përgjithshëm i ASIG-ut emërohet, lirohet ose shkarkohet nga Kryeministri me propozim të ministrit.".

Neni 4

Në pikën 3 të nenit 18 fjalët "i përcjell" zëvendësohen me fjalët "ia përcjell rregullat ministrit për propozim".

Neni 5
**Dispozitë kalimtare**

Buxheti i miratuar për vitin 2026 për Autoritetin Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor deri në rishikimin e ligjit nr. 87/2025 "Për buxhetin e vitit 2026" ekzekutohet në strukturën aktuale buxhetore në përputhje me rregullat e legjislacionit buxhetor në fuqi.

Neni 6
**Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 21.5.2026.

**Shpallur me dekretin nr. 356, datë 12.6.2026, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj.**